



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 08.05.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Projektligji “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Blerina Gjylameti, Antoneta Dhima, Ervin Bushati, Evis Kushi, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj, Arben Pëllumbi, Xhevit Bushaj, Reme Lala dhe Edmond Haxhinasto.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Dashamir Shehi, Fatbardha Kadiu, Agron Shehaj, Nadire Meçorapaj dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Elton Haxhi - Zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë

Dritan Fino - Drejtor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Ekonominë dhe Financat.

Sot në rendin e ditës së këtij komisioni është shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Javën që shkoi ne e kemi votuar projektligjin në parim, kështu që sot do të fillojmë menjëherë me nenet respektive.

Zoti Angjeli, fjala për ju.

Anastas Angjeli – Siç e thatë edhe ju në mbledhjen që zhvilluam herën e kaluar, duke marrë në konsideratë sugjerimet dhe vërejtjet e komisioneve të tjera, veçanërisht të Komisionit të Integritetit, qëllimi kryesor i ligjit është përafrimi me direktivën.

Si fillim, dua të them se shtojca në fund të faqes, që lidhet me titullin e projektligjit, duhet riformuluar si më poshtë: “Ky ligj është përafruar pjesërisht me direktivën 2013/34/BE të Parlamentit Europian dhe Këshillit të datës 26 qershor 2013 “Lidhur me pasqyrat financiare vjetore, pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportet që kanë të bëjnë me lloje të caktuara të ndërmarrjeve, që ndryshon direktivën 2006/43/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit dhe shfuqizon direktivat e Këshillit 78/660/KEE dhe 83/349/KEE”, e ndryshuar me direktivën 2014/95/BE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 22 tetor 2014 dhe Direktivën e Këshillit 2014/102/BE, datë 7 nëntor 2014. Numri CELEX 32013L0034, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 182, datë 29.06.2013, faqet 19-76”. Këto janë të gjitha të shkruara këtu.

A jeni dakord? Në rregull!

Erion Braçe – Vazhdojmë me nenin 1 “Objekti”.

Komisioni i Integritetit nuk ka gjë lidhur me këtë nen.

Anastas Angjeli – Edhe ne nuk kemi gjë për nenin 1.

Erion Braçe – Komisioni i Integritetit nuk ka.

E hedhim në votë nenin 1.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2 “Fusha e zbatimit”.

Anastas Angjeli – Në nenin 2, germa “c” do të hiqet.

Erion Braçe – Po, ky është edhe sugjerimi i Komisionit të Integritetit.

Elton Haxhi - Dua të bëj një sqarim të shkurtër.

Arsyeja pse ne e kishim vendosur germën “c” edhe te komentet, edhe te diskutimet që kemi pasur, është sepse kontabiliteti publik trajtohet nga ligje të tjera. Gjithashtu, edhe strategjia kombëtare për reformën në financat publike parashikon që ne do të fillojmë së shpejti një projekt me asistencë të huaj për implementimin e standardeve ndërkombëtare të raportimit në sektorin publik, kështu që do të bëhet një zgjidhje e plotë e sektorit publik.

Germa “c” e nenit 2 është vendosur me arsyen, sepse në disa raste ligji “Për financat publike” trajton në përgjithësi qeverisjen qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë ligjzbatuese në varësi të tyre. Ka raste që institucionet hibride, që kanë edhe vetëfinancim, por që janë me pjesëmarrje shtetërore mund të kenë paqartësi se cilin ligj të zbatojnë, sepse, normalisht, ato nuk e zbatojnë ligjin e financave publike, prandaj kishim vendosur germën “c”.

Megjithatë, në qoftë se kjo germë ka sjellë paqartësi dhe kundërshtime nga aktorë të ndryshëm, ne mund ta eliminojmë, sepse nuk sjell ndonjë implikim direkt, por, gjithsesi, ne e kishim lënë si garanci për të garantuar se kishte një zgjidhje.

Anastas Angjeli – Faleminderit!

Erion Braçe – E hedhim në votë nenin 2 me këtë ndryshim, pra me heqjen e germës “c”.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 3 “Përkufizime”.

Anastas Angjeli – Gjithashtu, pika 8 e nenit 3 do të hiqet.

Erion Braçe – Ndërkohë, Komisioni i Integritetit kërkon ...

Anastas Angjeli – Le t’i marrim me radhë dhe të mbarojmë njëherë me këtë.

Erion Braçe – Po, është pika 6 e nenit 3.

Anastas Angjeli – Po, por ne kemi rënë dakord edhe me pikën 13.

Erion Braçe – Vazhdojmë njëherë me pikën 6, më pas me pikën 8 e kështu me radhë.

Komisioni i Integritetit për pikën 6, të nenit 3, rreshti i parë thotë: “Fjalët “personat juridikë dhe fizikë, publikë dhe privatë” të zëvendësohen me fjalët “personat publikë dhe fizikë privatë”.

Anastas Angjeli – Po, ne e kemi diskutuar këtë çështje pak më parë dhe mendojmë se është më e plotë po ta lemë ashtu siç është.

Erion Braçe – Atëherë, nuk e marrim parasysht.

Anastas Angjeli – Po, nuk do ta marrim parasysh pikën 6. Ne do të marrim parasysh pikën 8.

Erion Braçe – Po pikën 13?

Anastas Angjeli – Po, edhe pikën 13, por të mbrojmë njëherë me pikën 8, se janë të ndara.

Erion Braçe – Atëherë, do t'i votojmë njëri pas tjetrit.

Anastas Angjeli – Pra, pika 13 e nenit 3 riformulohet si poshtë: “Interes në pjesëmarrje”, të drejtat në kapitalin e njësive ekonomike të tjera, pavarësisht nëse paraqiten apo jo me certifikata, të cilat, duke krijuar një lidhje të fortë me këto njësi ekonomike të tjera, kanë për synim të ndihmojnë në veprimtaritë e njësive ekonomike që i mban këto të drejta. Zotërimi i një pjese të kapitalit të një njësie ekonomike tjetër presumohet se përbën interes në pjesëmarrje kur e kalon pragun prej 20%.”

Erion Braçe – A ka ndonjë shqetësim tjetër lidhur me nenin 3?

Anastas Angjeli – Jo, janë vetëm këto dy ndryshime. Pra, pika 8 mendojmë të hiqet dhe pika 13 të qëndrojë sipas riformulimit të mësipërm.

Erion Braçe – Urdhëroni, zoti Haxhinasto.

Edmond Haxhinasto – Faleminderit, kryetar!

Në nenin 4 “Kategoritë e njësive ekonomike dhe grupeve”...

Anastas Angjeli – Jemi ende te neni 3.

Edmond Haxhinasto – Këtë e di, por neni 4 u referohet njësive ekonomike, pra i referohet edhe pikës 6, por normalisht edhe pikës 7, sepse këto janë njësi ekonomike që janë fitimprurëse sipas kategorizimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Anastas Angjeli – Ne e lamë pikën 6.

Edmond Haxhinasto - Po pikën 7, a do ta lemë? Po mirë pra, dakord!...

Pika 4 zbërthen njësitë ekonomike dhe grupet.

Anastas Angjeli - Që janë në pikën 6.

Edmond Haxhinasto - Është pika 6 ose pika 7.

Anastas Angjeli - Të dyja janë.

Edmond Haxhinasto – Po, por këtu thua “njësi ekonomike”. Ose do të unifikosh termin 6 me 7, do ta bësh një, ose te titulli i pikës 4 do të shtosh termin “fitimprurëse”.

Anastas Angjeli – Cilën fjalë?

Edmond Haxhinasto – Fjalën “fitimprurëse”, që të përfshijë edhe pikën 7.

Erion Braçe – E kemi lënë pikën 7 kështu siç është.

Edmond Haxhinasto – Po.

Erion Braçe – Nuk e prekim.

Edmond Haxhinasto – Po, nuk e prekim.

Erion Braçe – Pikën 6 e kemi lënë. Duhet të përfshiheshin te 4-a në rast se do të ...

Edmond Haxhinasto – Po, por shpjegimi që jep te pika 4 përfshin edhe pikën 7.

Anastas Angjeli – Kur të arrijmë te pika 4, flasim.

Edmond Haxhinasto – Dakord, por unë po them ...

Erion Braçe – Pika 4: “Standardet ndërkombëtare të raportimit financiar” apo në nenin 4?

Edmond Haxhinasto – Neni 4.

Erion Braçe – Dakord. Mendova mos ishte pika 4, “Standardet ndërkombëtare”.

Edmond Haxhinasto – Më kuptoni çfarë po them!

Erion Braçe – Dakord, por kur të arrijmë te pika 4 ...

Edmond Haxhinasto – Jo, duhet të bëjmë ndryshime tani te neni 3.

Anastas Angjeli – Çfarë do te neni 3?

Edmond Haxhinasto – Ti te neni 4 shpjegon njësitë që ke te pikat 6 dhe 7 të nenit 3.

Pra, ose do të unifikosh pikat 6 dhe 7, ose tek titulli i nenit 4 do të shtosh fjalën “fitimprurëse”.

Erion Braçe – Dakord, kur të arrijmë te 4-a.

Edmond Haxhinasto – Unë e thashë tani, sepse mund të ndryshojmë edhe pikat 6 me 7, mund t’i unifikojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Erion Braçe – Unë mendoj se pikat 6 dhe 7 duhet të mbeten kështu dhe te pika 4 shtojmë fjalën “fitimprurëse”.

Anastas Angjeli – Si ta shtojmë, tek titulli?

Erion Braçe – Tek titulli.

Anastas Angjeli – Pse njësitë ekonomike nuk e presupozojnë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kur thua “njësi ekonomike” i ka të gjitha.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më fal, po e cilësove “një njësi ekonomike dhe fitimprurëse” mbetesh i kufizuar te njësitë ekonomike fitimprurëse. Po the “njësi ekonomike”, e ke edhe atë të pikës 6, edhe atë të pikës 7.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Te neni 4 po flas.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, neni 4 i përfshin të gjitha. Ju thoni “bëheni ndryshe nenin 4”. Po e bëjmë ndryshe, do të përshijë njërën, ose pikën 6, ose pikën 7. Kështu siç është përfshin edhe pikën 6, edhe pikën 7.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Te njësitë ekonomike janë edhe fitimprurëset.

Evis Kushi – Thotë që këtu e ke specifikuar ndryshe, ke veç njësi ekonomike dhe veç ...

Anastas Angjeli – Jo, flet tek titulli.

Evis Kushi – E kuptoj.

Edmond Haxhinasto – Për të qenë konsistent me ndarjen e nenit 3, pikat 6 dhe 7 ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Evis Kushi – Po, ka sens.

Anastas Angjeli – Dakord.

Është çështje redaktoriale, ta rregullojnë specialistët.

Elton Haxhi – Të sqaroj diçka.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Erion Braçe – Po, urdhëroni për të bërë një sqarim!

Elton Haxhi – Njësitë ekonomike përfshijnë njësitë ekonomike fitimprurëse dhe njësitë ekonomike jofitimprurëse. Pra, “njësitë ekonomike” është përkufizim për të dyja grupet.

Njësitë ekonomike jofitimprurëse janë sqaruar në pikën 7 për të definuar natyrën e tyre. Normalisht njësitë ekonomike i përfshijnë të dyja grupet, ndaj neni 4 u referohet thjesht njësive ekonomike dhe i përfshin të dyja, edhe fitimprurëset, edhe jofitimprurëset.

Anastas Angjeli – Jemi të detyruar ta bëjmë, sepse njësitë ekonomike jofitimprurëse trajtohen ndryshe edhe nga pikëpamja fiskale.

Megjithatë, Dritan, shikojeni në fund bashkë me stafin, që të mos ketë kakofoni.

Erion Braçe – Hedhim në votë nenin 3 me ndryshimet e propozuara edhe nga Komisioni i Integritetit. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 4.

Do të shikoni titullin, që të mos kemi problematika.

Anastas Angjeli – Po, kemi pikat 4 dhe 6, që kërkojnë të riformulohen së bashku me Komisionin e Integritetit.

Pika 4: “Kufijtë për kriteret e shumës së aktivitet apo të të ardhurave nga veprimtaria ekonomike e qarkullimit, të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, rriten çdo 3 vjet në mënyrë të përpjesëtuar, sipas aneksit 1, pjesë integrale e këtij ligji, me qëllim përafrimin e tyre të plotë në vitin 2028 me kriteret e përcaktuara në legjislacionin përkatës të Bashkimit Europian.”

Pika 6: “Pas përkufizimit të plotë të kufijve, sipas pikës 3 të këtij neni, me kufijtë e parashikuar në legjislacionin përkatës të Bashkimit Europian për të rregulluar efektet e inflacionit, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit duhet të paktën një herë në 5 vjet të rishikojë dhe, kur është e nevojshme, të propozojë ndryshimet e kriterëve të pikave 1 dhe 2 të këtij neni, bazuar në ruajtjen e inflacionit, të cilat miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për Financat.”

Erion Braçe – Dakord.

Ka ndonjë shqetësim për këto dy ndryshime? Nuk ka.

Hedhim në votim nenin 4 me të dyja ndryshimet që lexoi zoti Angjeli. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5, “Standardet kontabël që zbatohen për hartimin e pasqyrave financiare”.

Anastas Angjeli – Pika 2 e nenit 5 të riformulohet si më poshtë:

“Njësitë ekonomike me interes publik, si dhe rregullatorët e njësive ekonomike me interes publik, që veprojnë në fushën e kreditimit dhe të sigurimeve, duhet të zbatojnë standardet ndërkombëtare të raportimit financiar për hartimin e pasqyrave financiare, e përjashtojnë nga detyrimi i detyrueshëm i CNRF-ve dhe zbatojnë SKK-të, vetëm njësitë ekonomike me interes publik, sipas nenit 2, pika 23, germa “ç” në ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor”, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar, të ndryshuar, të cilat nuk i tejkalojnë kriteret e përcaktuara për nenin 4, pika 1/3 të këtij ligji”.

Erion Braçe – Ka ndonjë problem në nenin 5 me ndryshimet e propozuara nga zoti Angjeli? Nuk ka.

Hedhim në votë nenin 5. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim?

Miratohet.

Neni 6.

Anastas Angjeli – Deri te neni 21 nuk ka.

Erion Braçe – Zoti Angjeli nuk ka gjë.

Nga kolegët e komisionit për nenin 6 ka ndonjë gjë?

E hedhim në votë. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 7.

Zoti Angjeli.

Anastas Angjeli – Nuk ka.

Erion Braçe – As nga Komisioni i Integritetit nuk ka gjë.

Nga anëtarët e tjerë të komisionit ka ndonjë shqetësim? Nuk ka.

E hedhim në votë nenin 7. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 8, “Ruajtja e dokumenteve kontabël”.

Anastas Angjeli – Nuk ka.

Erion Braçe – Ka ndonjë shqetësim tjetër?

E hedhim në votë nenin 8. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 9.

Zoti Angjeli.

Anastas Angjeli – Nuk ka.

Erion Braçe – E hedhim në votë nenin 9. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 10.

Anastas Angjeli – Nuk ka.

Erion Braçe – Ka ndonjë shqetësim tjetër nga kolegët deputetë për nenin 10?

E hedhim në votë nenin 10. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te kreu III, “Përbërësit dhe pasqyrat financiare”.

Neni 11, “Qëllimi për pasqyrat financiare”.

Anastas Angjeli – Nuk ka.

Erion Braçe – Nga kolegët deputetë ka? Nuk ka

E hedhim në votë nenin 11

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Pasqyrat financiare të konsoliduara.

Anastas Angjeli – Nuk ka.

Erion Braçe – A ka gjë nga kolegët e komisionit? Nuk ka.

E hedhim në votë.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Miratohet.

Kalojmë te neni 13. Përbërësit e pasqyrave financiare.

Po, zoti Angjeli.

Anastas Angjeli – Nuk ka.

Erion Braçe - Atëherë e hedhim në votë nenin 13.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 14.

Zoti Angjeli?

Anastas Angjeli - Nuk ka.

Erion Braçe - E hedhim në votë nenin 14.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 15.

Zoti Angjeli, inventarin.

Anastas Angjeli – Nuk ka.

Erion Braçe – E hedhim në votë nenin 15.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 16. Shënimet shpjeguese.

Anastas Angjeli – Nuk ka.

Erion Braçe – A kanë ndonjë gjë kolegët deputetë? Nuk kanë.

E hedhim në votë nenin 16.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Nenin 17. Raporti i ecurisë dhe veprimtarisë.

Anastas Angjeli – Nuk ka.

Erion Braçe – A ka ndonjë gjë nga kolegët deputetë? Nuk ka.

E hedhim në votë nenin 17.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 18. Raporti jofinanciar.

Anastas Angjeli – Nuk ka.

Erion Braçe – A kanë ndonjë gjë për të thënë kolegët deputetë? Nuk kanë.

E hedhim në votë nenin 18.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 19.

Zoti Angjeli.

Anastas Angjeli – Nuk ka.

Erion Braçe – A kanë ndonjë gjë për të thënë kolegët deputetë? Nuk kanë.

E hedhim në votë nenin 19.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 20. Raporti i konsoliduar i ecurisë dhe veprimtarisë.

Zoti Angjeli.

Anastas Angjeli – Nuk ka.

Erion Braçe – A kanë ndonjë gjë për të thënë kolegët deputetë? Nuk kanë.

E hedhim në votë nenin 20.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 21.

Zoti Angjeli.

Anastas Angjeli – Te neni 21 germa “b” e pikës 8 duhet riformuluar si më poshtë:

“Në raste tejet të rralla, kur informacioni i nevojshëm për hartimin e raportit të konsoliduar për pagesat, që u bëhen institucioneve shtetërore në përputhje me këtë nen, nuk mund të merret për shpenzime joproporcionale ose pa vonesë të pajustificuar”.

Erion Braçe – A ka ndonjë vërejtje apo sugjerim lidhur me propozimin që bëhet për ndryshim? Nuk ka.

Atëherë e hedhim në votë propozimin e zotit Angjeli.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 22.

Zoti Angjeli.

Anastas Angjeli – Nuk ka.

Erion Braçe – Nga kolegët deputetë, a ka ndonjë sugjerim për nenin 22? Nuk ka.

E hedhim në votë nenin 22.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 23. Përgjegjësitë.

Zoti Angjeli.

Anastas Angjeli – Jo, nuk ka.

Erion Braçe – Nga kolegët e tjerë? Nuk ka.

E hedhim në votë nenin 23.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu 4. Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit.

Neni 24. Statusi dhe detyrat.

Zoti Angjeli.

Anastas Angjeli – Nuk ka.

Erion Braçe – Nga kolegët e tjerë? Nuk ka.

E hedhim në votë nenin 24.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 25. Përbërja dhe mandati.

Anastas Angjeli – Nuk ka.

Erion Braçe – A ka ndonjë sugjerim tjetër? Nuk ka.

E hedhim në votë nenin 25.

Kush është dakord? Kundër?

Po, urdhëroni!

Roland Xhelilaj – Te pika 7, germa “d” “Nuk përmbush kërkesat e caktuara në Rregulloren e Brendshme të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit” duket disi pa vend katër kërkesat e mësipërme, si: vdes, jep dorëheqjen, bëhet i paaftë për shkak të sëmundjeve, kryen një vepër penale, vret, pastaj te rregullorja më duket pak e fortë. Nuk me bind.

Anastas Angjeli - Këto janë standarde në shumë institucione.

Erion Braçe – Nejse, kështu është pothuajse në të gjitha ligjet.

Anastas Angjeli – Në të gjitha institucionet e pavarura rastet më të identifikuara janë këto.

Erion Braçe – Bie fjala, mund të jetë caktuar në rregullore që ai nuk paraqitet në punë. Çfarë të bëjmë ne? Ta mbajmë atje?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E hedhim në votë nenin 25.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Nenin 26. Organizimi dhe funksionimi.

Zoti Angjeli.

Anastas Angjeli – Nuk ka vërejtje.

Erion Braçe – E hedhim në votë nenin 26.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 27. Raportimi.

Anastas Angjeli – Nuk ka vërejtje.

Erion Braçe - A ka ndonjë sugjerim nga kolegët deputetë? Nuk ka.

E hedhim në votë nenin 27.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 28. Burimet dhe financimi.

Anastas Angjeli – Nuk ka vërejtje.

Erion Braçe – Nga kolegët deputetë, a ka ndonjë vërejtje? Nuk ka.

E hedhim në votë nenin 28.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 29. Shkeljet dhe dënimet.

Anastas Angjeli – Nuk ka vërejtje.

Erion Braçe - E hedhim në votë nenin 29.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kreu 5. Dispozitat kalimtare.

Neni 30. Aktet nënligjore.

Zoti Angjeli.

Anastas Angjeli – Nuk ka vërejtje.

Erion Braçe – E hedhim në votë nenin 30.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 31. Dispozitat kalimtare.

Anastas Angjeli – Nuk ka.

Erion Braçe – E hedhim në votë nenin 31.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 32. Shfuqizime.

Anastas Angjeli – Nuk ka vërejtje.

Erion Braçe – E hedhim në votë nenin 32.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 33.

Anastas Angjeli – Nuk ka vërejtje.

Erion Braçe – E hedhim në votë nenin 33.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E hedhim ligjin në votim në tërësi me të gjitha ndryshimet e miratuara nga ky komision.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Ligji mbyllet këtu.

Ndërkohë do të doja t'ju lajmëroja që nesër kemi seancën dëgjimore për raportim vjetor të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Kemi kohë edhe sot për të depozituar pyetjet. Deri tani vetëm unë dhe dy kolegë deputetë dhe unë kemi depozituar pyetje, por në rast se keni pyetje të tjera në lidhje me veprimtarinë e AMF-së, jeni të lutur t'i depozitoni. Nesër do të bëhet prezantimi i raportit nga ana e drejtorit Ekzekutiv dhe Këshillit Mbikëqyrës së AMF-së, do të jetë edhe relatimi në emër të komisionit, ndërkohë që do të vazhdojmë me përgjigjet e pyetjeve në një seancë të dytë. Kështu që, ju lutem që deri nesër të depozitohen të gjitha pyetjet që kanë të bëjnë me veprimtarinë e AMF-së. Ky është një autoritet shumë i rëndësishëm për të cilin ka pasur shqetësime të ndryshme në harkun e një viti, prandaj jeni të lutur të adresoni pyetjet tuaja.

Faleminderit!

Këtu mbyllet mbledhja.

Ditën e mirë!

MBYLLET MBLEDHJA